



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:079087
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05435322

P.nr.211/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të akuzuarve R. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe F. I. për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.399/2023 e datës 14.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 12.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit R. A. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Vehbi Beqiri, si dhe të akuzuarit F. I., me datë 14.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- I. R. A.**, nga i ati E., e ëma R., e vajzërisë S., i lindur me datë ... në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin F.- Mitrovicë, me numër personal të identifikimit ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike- përfitues i ndihmës sociale, ka të kryer vitin e parë të shkollës së mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.03.2023 deri me datën 22.05.2023.
- II. F. I.**, nga i ati B., e ëma M., e vajzërisë H., i lindur me datë ... në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën “...” në Mitrovicë, me numër personal të identifikimit ..., i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

- I. R. A.**

SEPSE:

Me datë 24.03.2023 rreth orës 18:00, në Lagjen Kolonia në rrugën “...” Mitrovicë i pandehuri R. me dashje i shkakton lëndime trupore F. I. ashtu që derisa F. kishte qenë me automjetin e tij ne afërsi te shtëpisë së tij, në rrugë para derës së hyrjes së shtëpisë së tij kishte qenë i ndalur me automjet i pandehuri R., F. kishte blinduar me drita dhe i kishte rënë burisë qe t’ia liroj rrugën

dhe aty ka filluar një mosmarrëveshje ne mes tyre, e cila ka kaluar në rrahje, më pas i pandehuri R. shkon në automjet e merrë një çelës-shufër hekuri dhe me të njëjtën e godet F. I. në kokë duke i shkakuar lëndime të lehta trupore të vërtetuara nga ekspertiza mjeko ligjore si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale : Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

II. F. I.

Me datë, kohë dhe vend të njëjte si në piken e parë të kësaj aktakuze se i pandehuri F. me dashje i shkakton lëndime trupore R. A. ashtu që derisa F. kishte qenë me automjetin e tij ne afërsi të shtëpisë së tij, në rrugë para derës së hyrjes së shtëpisë së tij kishte qenë i ndalur me automjet i pandehuri R., F. kishte blinduar me drita dhe i kishte rënë burisë që t'ia liroj rrugën dhe aty ka filluar një mosmarrëveshje në mes tyre, e cila ka kaluar në rrahje, e si rezultat i kësaj rrahje i pandehuri F. i shkakton lëndime R. A. dhe atë lëndime të lehta trupore të vërtetuara nga ekspertiza mjeko ligjore si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale : Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 79 lidhur me nenin 185 par. 2 dhe 185 par. 1 të KPRK-së, si dhe neneve: 364, 365, 449, 452, dhe 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

G J Y K O N

- I. Të akuzuarit R. A., i shqipton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) vite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast të revokimit të dënimit me kusht, në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.03.2023 e deri me datën 22.05.2023.
 - I dëmtuari F. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- II. Të akuzuarit F. I., i shqipton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
 - I dëmtuari R. A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- III. Në mbështetje të nenit 276 par. 1 të KPP-së, nga i akuzuari R. A. URDHËROHET konfiskimi i përhershëm sendeve: çelësit - shufër hekuri. URDHËROHET Policia e Kosovës, që pas

plotfuqishmërisë së aktgjykimit, sendet- çelësi të shkatërrohet sipas procedurave standarde ligjore në fuqi.

- IV. I akuzuari R. A. lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, dhe të njëjtat bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- V. I akuzuari F. I. obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.399/2023 të datës 14.04.2023 kundër të akuzuarve R. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe F. I. për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.05.2023, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i akuzuari R. A. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Vehbi Beqiri, si dhe i akuzuari F. I..

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 19.05.2023, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari R. A. ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas aktakuzës, është penduar thellë për atë që ka ndodhur, ka qenë me familje ka pasur vajzat e vogla me vete atë ditë dhe ka ndodhur aksident, ndërsa të akuzuarin F. më parë kurrë nuk e ka njohur, ka qenë koha e ramazanit dhe ndoshta që të dy nuk kanë qenë vetvetja. Për momentin është i papunë i ka fëmijët e vegjël, jeton në një shtëpi të cilën ia ka dhuruar H. K.. Ka shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur. I ka kërkuar falje të akuzuarit F. I. për rastin që ka ndodhur dhe gjykatës. I premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe asnjëherë nuk do të përsërisë më veprime të tilla.

Prokurori i shtetit Arjan Xhema lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit R. A. ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqenëse një pranim i tillë është bërë konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në faktet që përmban akuza dhe ka mbështetje në provat të cilat janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës. I ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit duke marrur parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. A., Av. Vehbi Beqiri lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit R. A. ka deklaruar se, konsideroi se i akuzuari me pranimin e fajësisë dhe elaborimin

që e bëri për arsyet dhe gjendjen e tij në veçanti se deri tek rasti ka ardhur aty për aty, dhe se nuk ka qenë paraprakisht qëllimi i tij që t'i shkaktoj lëndime, konsideroj se gjykata duhet të marr parasysh në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit duke i propozuar të njëjtës që ta pranoj edhe pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit.

I akuzuari F. I. për veprën penale për të cilën akuzohet, ka deklaruar se nuk e ndjen veten fajtor sipas aktakuzës.

Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit R. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të KPRK-së, ndërsa sa i përket shpalljes së aktgjykimit ka vendosur që për të akuzuarin R. A. do të bëhet shpallja e aktgjykimit pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor edhe ndaj të akuzuarit F. I.

I akuzuari F. I., nuk ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës ose kundërshtimin e provave.

Gjykata, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 25.01.2024, në të cilën kanë qenë prezent Prokurori i shtetit Ajtene Zoni si dhe i akuzuari F. I..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari F. I. lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vie keq për rastin që ka ndodhur, nuk ka qenë asgjë e qëllimshme, nuk kanë pasur problem dhe as nuk e ka njohur R. më herët. I ka premtuar gjykatës se në të ardhmen R. nuk do të ketë më probleme nga ana e tij. I ka kërkuar falje gjykatës dhe të akuzuarit R. A., duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla dhe do të jetë më i kujdesshëm.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit F. I. ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqenëse një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në mënyrë vullnetare, se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i njoftuar të akuzuarit se pas pranimi të fajësisë, nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të akuzuarit.

Pasi që Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë për të akuzuarin F. I., ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.02.2024 lidhur me fjalën përfundimtare të palëve, në të cilën seancë kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i akuzuari R. A. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Vehbi Beqiri, si dhe i akuzuari F. I.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës meqenëse gjatë shqyrtimeve gjyqësore të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit t'i shpall fajtorë për veprat e kryera penale, t'iu shqiptoj sanksion penal me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, ashtu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese të merr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. A., av. Vehbi Beqiri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, fillimisht i mbrojturi i tij që nga procedimi i parë në polici ka pranuar fajësinë por edhe në seancën fillestare para kësaj gjykate, e kështu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykatës i propozoi në veçanti rrethanat lehtësuese: pranimi i fajësisë, pendimi real, pajtimin mes palëve ky rast ka qenë incidental – aty për atyshëm, ka qenë muaj i Ramazanit – koha e iftarit, që të dy që nga ajo kohë e deri më sot nuk kanë pasur asgjë të keqe mes vete, dhe konsideroi se koha e arrestit shtëpiak ka qenë e mjaftueshme për ta kuptuar i akuzuari se veprimet e tij kanë qenë të ngutshme, andaj konsideroi se edhe me shqiptimin e ndonjë dënimi alternativ do të arrihet qëllimi ligjor i sanksionit penal. Për fund i akuzuari R. A. gjykatës, prokurorisë por edhe të bashkakuzuarit i kërkon falje dhe i premtonte se me veprimet e tij nuk do të bie ndesh me ligjin.

I akuzuari R. A., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e mbështet në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij. I vie keq për rastin që ka ndodhur, premtonte se në të ardhmen nuk do të përsëritet më, me F.in janë pajtuar dhe nuk kanë asgjë të keqe mes vete.

I akuzuari F. I., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vie keq për rastin që ka ndodhur, tani me R.in janë pajtuar, nuk kanë asgjë të keqe mes vete dhe i premtonte gjykatës se në të ardhmen veprime të tilla më nuk do të përsëriten.

Gjykata, pasi që i akuzuari R. A. e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa i akuzuari F. I. e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është lëshuar në administrimin e provave në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo me rastin e pranimin të fajësisë, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si, Raporti Fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-BC-311 i datës 24.03.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin R. A., i datës 24.03.2023, Raporti nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencja në Mitrovicë, për të pandehurin R. A., i datës 24.03.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin-tani të akuzuarin F. I., i datës 24.03.2023, Raporti nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencja në Mitrovicë, për të pandehurin F. I., i datës 24.03.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitaren F. A., i datës 24.03.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitaren A. A., i datës 24.03.2023, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 24.03.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit R. A. në Procedurë paraprake i datës 30.03.2023, Ekspertizat mjeko-ligjore për të pandehurit R. A. dhe F. I., të datës 31.03.2023 si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që

në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që u vihen në barrë.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarve dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari R. A. ka kryer veprën penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, ndërsa i akuzuari F. I. ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 të KPRK-së e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin R. A. ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhje e shprehur dhe pendimin e thellë për veprën e kryer, faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike dhe përfitues i ndihmës sociale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, kërkim faljen ndaj të akuzuarit F. si dhe faktin se me të njëjtin i kanë rregulluar raportet në mes vete. Ndërsa, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin F. I. ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, kërkim faljen ndaj të akuzuarit R. si dhe faktin se me të njëjtin i kanë rregulluar raportet në mes vete. Ndërsa, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimet e shqiptuara si në dispozitivin e aktgjykimit, janë në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se edhe me dënime të tilla do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar në rast të revokimit të dënimit me kusht për të akuzuarin R. A., gjykata e mori në bazë të nenit 79 të KPRK-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit, të akuzuarit R. A. i ka konfiskuar çelësin- shufër hekuri, Gjykata duke marrë për bazë sigurinë juridike si dhe faktin se sendet e konfiskuara janë rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lart, kjo në mbështetje të nenit 276 par.1 të KPP-së, ku përcaktohet se *“Pasuria që është qenësish e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet konfiskimit, në cilëndo fazë të procedurës nga gjyqtari kompetent, pa*

marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit dhe pavarësisht nëse prokurori i shtetit e ka ndërmarrë apo jo ndonjë veprim për ta konfiskuar pasurinë”.

Gjykata konform nenit 452 par. 4 të KPP-së, të akuzuarin R. A. e ka liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor për shkak të gjendjes materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t’i mbështesë materialisht, për faktin se ai është i gjendjes së dobët ekonomike si dhe përfitues i ndihmës sociale e kjo vërtetohet në bazë të kartelës së ndihmës sociale me nr.42843, lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale për sa i përket të akuzuarit F. I. gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e mori në kuptim të nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata, të akuzuarit R. A. me aktvendim të veçantë P.nr.211/2023 të datës 22.05.2023, i ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak, ku edhe janë dhënë arsyet për një vendim të tillë.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal
P.nr.211/2023, datë: 11.03.2024

Zyrtari Ligjor
Besart Mustafa

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.